



# Shqipëria

## Ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në 1996

### Gjyqtari vendas: Ledi Bianku

CV-të e gjyqtarëve mund të lexohen në faqen e internetit të GJEDNJ-së

Gjyqtari i mëparshëm: Kristaq Traja (1998 – 2008)

Në vitin 2016 Gjykata ka trajtuar 66 kërkesa që kanë të bëjnë me Shqipërinë, prej të cilave 44 janë deklaruar të papranueshme ose janë çregjistruar nga lista. Gjykata ka marrë 10 vendime (për 22 kërkesa), ku është gjetur së paku një shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkesa proceduara në të	2014	2015	2016
Kërkesa për të cilat është caktuar trupi gjyqësor	82	147	147
Të komunikuar Qeverisë	38	99	109
Kërkesa për të cilat është marrë një vendim:	150	101	66
- Të shpallura të papranueshme ose të çregjistruara nga lista (një gjyqtar)	113	56	24
- Të shpallura të papranueshme ose të çregjistruara nga lista (Komitete)	10	20	19
- Të shpallura të papranueshme ose të çregjistruara nga lista (Dhomë)	6	3	1
- Të vendosura me vendim (judgment)	21	22	22
Masë e përkohshme:	1	1	2
- Të miratuara	0	0	1
- Të refuzuara (përfshirë kërkesa jashtë objektit)	1	1	1

Për informacion rreth përbërjes gjyqësore të Gjykatës dhe procedurat, shih faqen e internetit të GJEDNJ-së.

Kërkesa në pritje të një vendimmarrje nga Gjykata deri më 01/01/2017	
Totali i kërkesave që janë në pritje të një vendimmarrje *	504
Kërkesa përpara një trupi gjyqësor:	488
Një gjyqtar	10
Komitet (3 gjyqtarë)	214
Dhomë (7 gjyqtarë)	264
Dhomë e Madhe (17 gjyqtarë)	0

\* përfshirë kërkesat për të cilat formularët e plotësuar të kërkesave nuk janë marrë

### Shqipëria dhe kontributi i saj në buxhetin e Gjykatës

Për vitin 2017, buxheti i Gjykatës është përafërsisht 71 milionë euro. Ky buxhet financohet nga kontributet e 47 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, në përputhje me përqindjen e bazuar në numrin e banorëve dhe PBB-në (Produktin e Brendshëm Bruto); kontributi i Shqipërisë në buxhetin e Këshillit të Evropës (328 milionë euro) për vitin 2017 është **479,331 euro**.

### Sekretariati i Gjykatës

Detyrë e Sekretariatit të Gjykatës është që të ofrojë mbështetje ligjore dhe administrative për Gjykatën në ushtrimin e detyrave të saj gjyqësore. Sekretariati përbëhet nga juristë, staf administrativ dhe teknik, si dhe përkthyes. Aktualisht janë 672 punonjës në Sekretariatit të Gjykatës, nga të cilët **5** janë shqiptarë.

## Çështje me rëndësi, vendime të shpallura (judgments)

### Dhoma

#### Çështjet në lidhje me të drejtën për jetën (Neni 2)

##### Rrapo kundër Shqipërisë

25.09.2012

Çështja kishte të bënte me ekstradimin e kërkuesit nga Shqipëria në SHBA, në nëntor të vitit 2010, ku ai u përball me akuzat për një sërë veprash të rënda përfshirë anëtarësimin në një organizatë mashtruese që merrej me vrasje, rrëmbime, shpërndarje drogash, zjarrëvnie të qëllimshme, grabitje dhe zhvatje.

[Nuk ka shkelje të Nenit 2](#)

[Nuk ka shkelje të Nenit 3 \(ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës\)](#)

[Nuk ka shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr.13 \(heqja e dënimit me vdekje\)](#)

[Shkelje e Nenit 34 \(kërkesat individuale\)](#)

#### Çështjet në lidhje me kushtet e paraburgimit dhe kujdesit shëndetësor (Neni 3)

##### Groni kundër Shqipërisë

07.07.2009

Çështja kishte të bënte me ankimin e kërkuesit për kujdes të pamjaftueshëm mjekësor në burg dhe për paligjshmërinë e burgosjes së tij për zbatimin në Shqipëri të dënimit me burgim të përjetshëm të marrë në mungesë nga gjykatat italiane.

[Shkelje e Nenit 3 \(ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës\)](#)

[Shkelje e Nenit 5 \(e drejta për liri dhe siguri\) dhe 34 \(kërkesat individuale\)](#)

##### Dybeku kundër Shqipërisë

18.12.2007

Çështja kishte të bënte me kushtet e paraburgimit të kërkuesit dhe kujdesit mjekësor që i është dhënë në burg, të cilin ai e konsideronte si të papërshtatshëm duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore.

[Shkelje e Nenit 3 \(ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës\)](#)

#### Çështjet në lidhje me Nenin 6

##### E drejta për një proces të rregullt

##### Haxhia kundër Shqipërisë dhe Mulosmani kundër Shqipërisë

08.10.2013

Këto çështje kishin të bënin me procedimet penale kundër dy oficerëve të lartë të policisë, pas vrasjes së deputetit opozitar dhe trupprojës së tij në vitin 1998.

Njëri nga oficerët e policisë ishte dënuar për vrasje, kurse oficeri tjetër ishte dënuar për ndihmë në vrasje dhe bashkëfajësi.

[Nuk ka shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 \(a\) deri në \(d\)](#)

[Gjykata shpalli të papranueshme veçanërisht ankimet e kërkuesit sipas Nenit 6 § 2 \(presumimi i pafajësisë\)](#)

##### Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë

31.07.2012- vendim pilot<sup>1</sup>

Çështja kishte të bënte me ankimet e 20 shqiptarëve, të cilët pavarësisht se kishin trashëguar tituj pronësie mbi sipërfaqe toke të njohura nga autoritetet, vendimet administrative të formës së prerë që u jepnin kompensim në një nga format e njohura nga ligji në lidhje me kthimin e pronësisë nuk u zbatuan asnjëherë.

[Shkelje e Nenit 13 \(e drejta për zgjidhje efektive\)](#)

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 1 Protokollit nr. 1 \(mbrojtja e pronës\).](#)

Duke patur parasysh që ankimet reflektonin një problem të shtrirë gjerësisht në Shqipëri duke pasur ndikim mbi një numër të madh njerëzish, në këtë çështje Gjykata vendosi të zbatojë procedurën e vendimit-pilot. Ajo konstatoi se Shqipëria duhet të merrte masa të përgjithshme për të

<sup>1</sup> Që nga viti 2004 dhe në përgjigje të një numri të madh të rasteve që burojnë nga problemet sistematike apo strukturore në disa shtete të caktuara, Gjykata ka krijuar procedurën e vendimit-pilot. Kjo konsiston në identifikimin në një vendim të vetëm të problemeve sistematike që përmbajnë shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe duke treguar në të njëjtin vendim masat efektive që kërkohen për zgjidhjen e situatave të tilla. Procedura e vendimit-pilot nuk ka për qëllim vetëm që të mundësojë zbatimin efektiv të masave të përgjithshme dhe individuale nga shtetet e paditura në përputhje me vendimet e Gjykatës, por ajo gjithashtu nxit shtetin e paditur që të zgjidhë një numër të madh të çështjeve individuale që burojnë nga i njëjti problem strukturor në nivel vendi, duke fuqizuar kështu parimin e subsidiaritetit që përforcon sistemi i Konventës.

siguruar në mënyrë efektive të drejtën e kompensimit brenda 18 muajve që nga data kur vendimi të merrte formë të prerë.

### **Çaus Driza kundër Shqipërisë**

15.03.2011

Çështja kishte të bënte, *inter alia*, me mungesën e një mjeti efektiv ligjor në sistemin e brendshëm në lidhje me të drejtën e kërkesit për kompensim në natyrë në vend të kthimit fizik të pronës.

[Shkelje e Nenit 13 \(e drejta për një mjet efektiv ligjor\)](#)

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 1 Protokoll nr. 1 \(mbrojtja e pronës\)](#)

### **Laska dhe Lika kundër Shqipërisë**

20.04.2010

Çështja kishte të bënte me parregullsinë e procedurave penale kundër kërkuessve, veçanërisht mënyrës sesi ishte realizuar procesi i identifikimit ku kërkuessit u detyruan të veshin maska me të njëjtën ngjyrë si autorët e krimit, në mungesë të avokatëve të tyre.

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

### **Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë**

23.03.2010

Çështja kishte të bënte me mungesën e një intepretimi ligjor të qëndrueshëm nga ana e Gjykatës së Lartë në lidhje me ligjshmërinë e një leje ndërtimi akorduar kërkuessve.

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 1 Protokoll nr. 1](#)

### **Gjyli kundër Shqipërisë**

29.09.2009

Çështja kishte të bënte me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë të gjykatave të brendshme që urdhëronin rikthimin e kërkuessit në vendin e mëparshëm të punës si dhe mungesën e një mjeti efektiv kundër mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 13 \(e drejta për një mjet efektiv ligjor\)](#)

### **Driza kundër Shqipërisë dhe Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë**

13.11.2007

Këto çështje kishin të bënin me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe administrative për kthimin e pronave, një problem i përhapur gjerësisht me ndikim tek një grup i madh njerëzish në Shqipëri.

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 \(mbrojtja e pronës\)](#)

[Shkelje e Nenit 13 \(e drejta për zgjidhje efektive\)](#)

[E drejta e aksesit në gjykatë](#)

### **Shkalla kundër Shqipërisë**

10.05.2011

Çështja kishte të bënte me procedurat penale të parregullta të kryera në mungesë kundër kërkuessit dhe pengimin e të drejtës së tij për akses në gjykatë si rrjedhojë e refuzimit të Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankimin e tij kushtetues.

[Shkelje e Nenit 6 § 1 \(aksesi dhe parregullsia\)](#)

[E drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm](#)

### **Mishqjoni kundër Shqipërisë**

07.12.2010

Çështja kishte të bënte me ankimin e kërkuesses për stërzgjatje të procedurave gjyqësore që kishin të bënin me largimin nga puna si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit. Gjithashtu ajo u ankua se procedurat gjyqësore për pagesën e pagave të papaguara ishte tejte i gjatë dhe jo i drejtë.

[Shkelje e Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 13 në lidhje me Nenin 6 § 1 \(kohëzgjatja\)](#)

### **Gjonbocari dhe të tjerët kundër Shqipërisë**

23.10.2007

Çështja kishte të bënte me tri sete procedurash gjyqësore në të cilat kërkuessit kërkuan kthimin e tokës e cila dikur u përkiste prindërve të tyre, por që u ishte konfiskuar pa kompensim nga autoritetet gjatë kohës së regjimit komunist.

[Dy shkelje të Nenit 6 § 1](#)

[Shkelje e Nenit 13 \(e drejta për zgjidhje efektive\) në lidhje me Nenin 6 § 1](#)

**Çështje të tjera me rëndësi, vendime të shpallura (judgments)**

### **Alimuçaj kundër Shqipërisë**

07.02.2012

Çështja kishte të bënte me procedurat penale kundër kërkuessit për veprën penale të mashtrimit si rezultat i marrjes së

kredive nga publiku në periudhën ndërmjet viteve 1995 dhe 1997.

Nuk ka shkelje të Nenit 7 (për sa i përket cilësimit të veprimeve të kërkuarit si vepër penale sipas ligjit të brendshëm)

Shkelje e Nenit 7 (përsa i përket faktit se kërkuarit i ishte dhënë një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale)

## Çështje me rëndësi, vendime të shpallura (decisions)

---

### **Beleri dhe të tjerët kundër Shqipërisë**

Vendim i 10 maj 2016

Çështja kishte të bënte me ankimin e një grupi shtetasish shqiptarë që i përkisnin minoritetit greqisht-folës në lidhje me dënimin e tyre në Shqipëri për nxitje të urrejtjes kombëtare dhe denigrim të Republikës dhe të simboleve të saj.

Kërkesa është shpallur e papranueshme:

Ankimi sipas Nenit 10 (liria e shprehjes) e hedhur poshtë për mos-shterim të mjeteve të brendshme

Ankimet sipas Neneve 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm), 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe 13 (e drejta për zgjidhje efektive) janë refuzuar si haptazi të pabazuara

### **Ceka kundër Shqipërisë**

Vendim i 23.10.2012

Çështja kishte të bënte me vdekjen e djalit të znj. Ceka gjatë ndalimit në polici të kryer në korrik të vitit 2004 pas arrestimit të tij si i dyshuar për grabitje.

Duke pasur parasysh se në çështjen konkrete Qeveria pranoi se ka pasur shkelje të Neneve 2 dhe 3, si dhe propozimin e saj për pagimin e një kompensimi në një vlerë prej 10,000 euro – sipas vlerësimit të Gjykatës një shumë kjo e drejtë për rastin konkret - Gjykata konsideroi se nuk ishte më e arsyeshme që të vazhdojë me shqyrtimin e çështjes, dhe bazuar në Nenin 37 § 1 (c) (cregjistrimin e kërkesave nga

lista) vendosi që ta cregjistrojë nga lista e saj e çështjeve.

### **Vefa Holding sh.p.k. dhe Alimuçaj kundër Shqipërisë**

Vendim i 14.06.2011

Çështja kishte të bënte me rënien e një skeme piramidale dhe miratimin e legjislacionit korigjues që rezultoi me zhveshjen e kontrollit të kërkuarit mbi shoqërinë e tij dhe vendosjen nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të caktuar nga shteti.

Kërkesa u shpall e papranueshme pasi kërkuarit nuk kishin respektuar afatin kohor të parashikuar në Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

## Çështje me rëndësi që janë ende në pritje të një vendimmarrje

---

### **Kasmi kundër Shqipërisë (nr. 1175/06)**

Komunikuar Qeverisë Shqiptare në Shkurt 2009

Çështja ka të bëjë me pamundësinë e kërkuarit për të fituar posedimin e shtëpisë së tij, e cila aktualisht është e zënë nga qiradhënës. Mendohet se problemet e ngritura në këtë çështje mund të jetë me rëndësi edhe për ankues të tjerë potencialë. Z. Kasimi pretendon shkeljen e Nenit 1 të Protokollit nr.1 (mbrojtja e pronës) të Konventës.

### **Delijorgji kundër Shqipërisë (nr. 53694/08)**

Komunikuar Qeverisë Shqiptare në Shkurt 2011

Kjo çështje së bashku me tre çështje të tjera ka të bëjë me shpërthimin në një depo armësh në fshatin Gërdec, në mars të vitit 2008, ku u vranë më shumë se njëzet persona. Pas incidentit, z. Delijorgji, administrator i një shoqërie përgjegjëse për shkatërrimin e municioneve u arrestua dhe prona e tij u konfiskua.